



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË**  
**DEGA VENDORE TIRANË**

**NOTER ILIRJANA I. TABAKU**  
**ADRESA Njesia 11, Rr. Dritan Hoxha,**  
**Ndertesha 112, Kati 1**  
**TEL: 0682069620**

# **KONTRATË PENGU**

**(KONTRATË PENGU KUOTA TË SHOQËRISË)**

**Nr. repertori: 2869**

**Nr. koleksioni: 1479**

**Tirane më 26/11/2020**

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Notarinë"

\*Akti noterial përbëhet nga 5 fletë



A2020053580128631282

REPUBLIKA E SHQIPERISE

DHOMA E NOTEREVE

NR. 2869 REP.

NR. 1479 KOL.

**KONTRATË PER VENDOSJE PENGU  
MBI KUOTAT E SHOQERISE**

Sot ne Tirane, më datë 26 / 11 / 2020 përpara meje, noter Shijone Tekoku

paraqitën palët e mëposhtme:

**KREDIDHENES:** **PROCREDIT BANK sh.a**, person juridik i regjistruar ne Qendren Kombetare te Biznesit me nr. unik identifikimi te subjektit (Nipt) J91524011J, ne date 11.02.1999, me seli në Rruga "Dritan Hoxha", Tirane, liçensuar nga Banka e Shqipërisë me Liçensën Nr.12, datë 15/03/1999, e përfaqësuar nga personat e mëposhtëm, madhorë me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar:

**Znj.FJORELA ISUF NUREDINI**, lindur me datë 14.05.1992 me numer personal J25514092B, banues në RR. E DIBRES, PERBALLE PLL HALIMI , TIRANE madhor me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, identifikuar prej meje nëpërmjet pasaportes me Nr. BI6803514 leshuar me datë 24.02.2011.

**Znj. METINA BESNIK DEMOLLAJ**, lindur me datë 19.04.1995, me numer personal J55419019D, banues në ZHARES, PATOS FIER, madhor me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, identifikuar prej meje nëpërmjet kartes identitetit me Nr. 032039149, leshuar me datë 04.01.2013.


**KREDIMARRRES:** **Smart Watt SHPK** person juridik i regjistruar në Qendren Kombetare te Biznesit me nr.unik identifikimi te subjektit (NUIS) L72320013B, me seli ne adresen Tirane Kashar, Autostrada TR-DR, Rruga Egnatia, Tirana Industrial Park Kashar, e përfaqësuar nga Shefki Dema, lindur me date 21.10.1969, mbajtes i leternjoftimit me nr.034080342, leshuar me date 29.03.2019.

**PENG-LENESI:** **E T S SHPK**, person juridik i regjistruar në Qendren Kombetare te Biznesit me nr.unik identifikimi te subjektit (NUIS) K21307003N, me seli ne adresen Tirane, Kashar, Autostrada TR-DR, Rruga Egnatia, Tirana Industrial Park, Kashar, e përfaqësuar nga Shefki Dema, lindur me date 21.10.1969, mbajtes i leternjoftimit me nr.034080342, leshuar me date 29.03.2019.

**NDËRSA:**

- (A) ProCredit Bank sh.a, në cilësinë e "Kredihënësit", dhe Smart Watt Sh.p.k në cilësinë e "Kredimarrësit", kanë lidhur Kontratën e limitit financiar date 06.05.2020 ne shumen limit 1,500,000 (nje milione e peseqindmije) Euro, brenda te cilit eshte nenshkruar Kontrate Leter kredie me nr 05002445 date 06.05.2020 ne shumen 1,084,124.80 Eur, Kontrate Leter kredie me nr 05002446 dt 06.05.2020 ne shumen 190,397.60 Eur, (këtej e tutje referuar si "Kontratë").
- (B) Për të siguruar pagesën ndaj Kredihënësit të të gjitha shumave të detyruara nga Kredimarrësi sipas Kontratave te Kredive, ka rënë dakord te vendose ne favor te Kredihënësit peng të rradhes së parë dhe pari-passu mbi kuotat e shoqerise Smart Watt Sh.p.k në shumën prej jo më pak se 1,500,000 (nje milione e peseqindmije) Euro









- (C) **Tani e tutje**, duke patur parasysh angazhimet e përbashkëta dhe marrëveshjet e përfshira këtu, dhe në Kontratat e kredive, është rënë dakord si më poshtë:

## Neni 1 INTERPRETIMI

### 1.1 Përkufizime

Shprehjet me germa të mëdha do të kenë kuptimin e atribuar për to në Kontratat e mesiperme nëse nuk përcaktohet ndryshe në këtë kontratë. Për më tepër, në këtë kontratë shprehjet e mëposhtme kanë kuptimet e mëposhtme:

- (a) **"Peng"** ka kuptimin e atribuar për këtë shprehje në Pikën 2.1 në këtë dokument.
- (b) **"Kolateral"** ka kuptimin e atribuar për këtë shprehje në Pikën 2.1 në këtë dokument.
- (c) **"Detyrime të Siguruara"**, nënkupton të gjitha shumat e tanishme dhe të ardhshme, borxhet dhe detyrimet afarëdoqofshin (aktuale ose të ardhshme, të përbashkëta ose të vecuara dhe të përbashkëta dhe të vecuara) të pagueshme, që janë për tu paguar ose të shkaktuara nga Kredimarrësi/Debitori tek Kredidhënesi/Kreditori sipas ose në lidhje me Kontratat e kredive

### 1.2 Pavlefshmëria e dispozitave

Secila nga dispozitat e përfshira në këtë kontratë është e vecantë dhe e ndashme, dhe një deklaratë pavlefshmërie ose jodetyruese e këtyre dispozitave ose e një pjese të tyre nga gjykata e juridiksionit kompetent nuk do të ndikojë vlefshmërinë ose detyrimin e ndonjë dispozite tjetër në këtë dokument.

### 1.3 Ndryshim, heqje dore

Asnjë ndryshim apo heqje dore nga kjo kontratë nuk do të jetë detyruese nëse nuk do të realizohet me shkrim nga pala e lidhur në këtë dokument. Asnjë heqje dore nga ndonjë dispozitë e kësaj kontrate nuk do të përbëjë heqje dore nga ndonjë dispozitë tjetër, as heqja dorë nga ndonjë dispozitë e kësaj kontrate nuk do të përbëjë një heqje dore të vazhdueshme, me përjashtim të rasteve kur shprehimisht parashikohet ndryshe në kete marreveshje.

### 1.4 Afati

Kjo kontrate do te jete ne fuqi per nje afat te pacaktuar.

### 1.5 Ligji qeverisës

Kjo kontratë do të drejtohet dhe interpretohet në përputhje me ligjet e Shqipërisë.

## Neni 2 PENGU

- 2.1 Kredimarrësit si nje garanci per shlyerjen e e plote dhe te pakthyeshme te detyrimeve te garantuara me ane te ketij akti: - ne menyre te pakthyeshme, deri ne shlyerjen e detyrimit qe rrjedh nga kjo marreveshje, japin peng Kuotat ne favor te Kredidhenesit; -ne menyre te pakthyeshme bien dakort per dhenien e krijimin e nje pengu mbi kuotat e pjesemarrjes ne shoqeri dhe te drejtat e lidhura me to ne favor te Kredidhenesit si dhe mbi çdo kuote te re te shoqerise ose te drejtat e lidhura me to qe mund te zoterohen ne te ardhmen nga Kredimarrësit (Penglensit);
- 2.2 Pengu ndaj Kredidhenesit jepet si garanci e rradhes se pare per dhe deri ne permbushjen e plote dhe te pa kushtezuar te detyrimeve te siguruara.
- 2.3 Pengu ndaj Kredidhenesit nuk do te reduktohet ne asnje menyre per arsye te shlyerjes se pjeseshme te detyrimeve te garantuara.
- 2.4 Kredimarrësi duhet te pajise Kredidhenesin me vendimin e asamblese se ortakeve qe autorizon krijimin e pengut. Ky vendim dhe kontrata depozitohet ne Regjistrin Tregtar te Qendres Kombetare te Biznesit dhe sipas percaktimeve te pikes.
- 2.5 Kredimarrësit me ane te ketij akti autorizojne Kredidhenesin te nenshkruaje, kompletoje, regjistroje dhe depozitoje te gjithë dokumentat e metejshe qe Kredidhenesi konsideron te nevojshme ose te pershtateshme. Kredimarrësit do te nenshkruajne, kompletojne, regjistrojne, dergojne dhe depozitojne te gjithë dokumentat e metejshe qe Kredidhenesi mund te kerkoje ne menyre te arsyeshme per te realizuar qellimin e kesaj kontrate, per te kompletuar e siguruar vazhdimesine e pengut, per mbrojtjen dhe ruajtjen e kolateralit dhe ekzekutimin e te drejtave te Kredidhenesit sipas kesaj kontrate





2.6 Me pengjet e mësipërme Kredidhënësi sigurohet për:

- a) shlyerjen e principalit, interesit, rinovimeve, përmirësimeve dhe modifikimeve të parashikuara në këtë Kontratë ose në shtesat e ndryshimet e kësaj Kontrate përfshire edhe plan pagesat për levrimet e ardhshme nese ka ;
- b) shlyerjen e të gjitha shpenzimeve dhe komisioneve të ngarkuara mbi të, për të mbrojtur dhe për të siguruar këtë mjet garancie;
- c) të gjitha kamatat, shpërblimin e dëmit të shkaktuar nga vonesa e ekzekutimit, si dhe shpenzimet e bëra nga Kredidhënësi për shlyerjen e Kredisë.

2.7 Kredimarrësit deklarojne, pranojne dhe garantojne Kredidhënësin (Bankën) se:

- a) Kuotat e shoqerise, janë në pronësi të Kredimarrësve ;
- b) do paguajnë shpenzimet e sigurimit të tyre në emër të Kredidhënësit përkundrejt humbjes ose dëmtimit nga një rrezik i mundshëm, duke dorëzuar periodikisht duplikatat ose çertifikatat origjinale të lëshuara për këtë qëllim;

2.8 Në rast se për një ose disa shkaqe, të justifikueshme ose të pajustificueshme Kredimarrësit janë në pamundësi për të shlyer, Kredidhënësi ka të drejtë (përveç të drejtave të tjera të pranuar në këtë Kontratë) në çdo kohë ose herë pas here, me ose pa proces gjyqësor, me ndihmën ose pa ndihmën e të tretëve, të marrë në zotërim pasurite e lëna peng dhe të kryeje vetë ose të kërkojë të kryhen nga organet kompetente veprimet e nevojshme për ekzekutimin e detyrimit.

### Neni 3

#### DETYRIMET E SIGURUARA

##### 3.1 Detyrimet e siguruar

Pengu i ofruar siguron pagesën, performancën, dhe përmbushjen e gjithë Detyrimeve të Siguruara.

##### 3.2 Interesi i vazhdueshëm

Pengu do të jetë një Garanci e vazhdueshme pavarësisht se detyrimet mund të jenë të luhatshme dhe madje, herë pas here, mund të reduktohen në një bilanc zero, dhe pavarësisht faktit se detyrimi për të cilin Kredimarrësit janë përgjegjës mund të shlyhet para afatit dhe të ketë avancuar me tej në lidhje me afatin.

##### 3.3 Aplikimi i pagesave

Kuotat e ofruara peng që Kredidhënësi ka marrë nga Kredimarrësit do të përdoren për qëllimin e përmbushjes së Detyrimeve në mënyrë të tillë që të jetë në përputhje me dispozitat e **Kontratës se limitit financiar date 06.05.2020 ne shumen limit 1,500,000 (nje milione e peseqindmije) Euro**, si dhe Kontrates se Leter kredie me nr 05002445 date 06.05.2020 ne shumen 1,084,124.80 Eur dhe Kontrates se Leter kredie me nr 05002446 dt 06.05.2020 ne shumen 190,397.60 Eur.

### Neni 4


#### REGJISTRIMI I PENGUT

- 4.1 Kredidhenesi/ personat e autorizuar të Kredidhenesit do të dorëzojnë një Formular Njoftimi të Regjistrimit në përputhje me atë që është përshkruar nga Rregullorja mbi Barrat Siguruese ("Rregullorja") në Regjistrin Shqiptar të Barres Siguruese ("Regjistri") që do të hyjë në bazën e të dhënave të Regjistrit. Pas ketij regjistrimi lëshohet një certifikatë, që konfirmon regjistrimin e Barres së Sigurimit në Regjistrin perkates te kolateralit. Kjo certifikate lëshohet në përputhje me Rregulloren e RBS, dhe ne te pasqyrohen numri i regjistrimit, koha e regjistrimit, emri i Kredidhenesit dhe Kredimarresit, përshkrimi i Kolateralit, si dhe kohëzgjatja e Barres së Sigurimit.
- 4.2 Kredimarresi/ personat e autorizuar të Kredimarresit do të depozitojë prane Qendres Kombetare te Biznesit nje kerkese shoqeruar me nje kopje te kesaj kontrate me qellim regjistrimin e pengut. Nje ekstrakt zyrtar nga dosja tregtare e Kredimarresit qe mbahet prane Regjistrit Tregtar dhe provon regjistrimin e pengut, do ti dergohet Kredidhenesit menjehere me realizimin e regjistrimit.

Pasi Kredimarresi dhe Kredidhenesi të kenë marrë certifikatën e regjistrimit që pasqyron kontratën e lidhur nga palët këtu dhe ekstrakt zyrtar nga dosja tregtare e Kredimarresit që provon regjistrimin e pengut, Barra e sigurimit do të konsiderohet e vendosur.

### Neni 5

#### DETYRIMET E KREDIMARRRESIT





### 5.1 Detyrimie të përgjithshme

Kredimarrësi bie dakord që:

- a) do të njoftojë Kredidhënesin menjëherë për
  - i. cdo ndryshim në emër dhe në pronësi të Kredimarrësit;
  - ii. cdo humbje të Kolateralit;
  - iii. ndodhjen e ndonjë Ngjarje Mospërmbushje (sic është përcaktuar këtu)
- b) nuk do të shesë, transferojë, ose ndryshe tjetërsojë ose shkaterroje pronësinë mbi Kolateralin ose ndonjë interesi të kësaj kontrate,
- c) do të njoftojë menjëherë Kredidhënesin për cdo pretendim ose kërkesë në lidhje me cdo pjesë të Kolateralit dhe për cdo ngjarje tjetër që ndikon mbi Kolateralin, i cili në secilin rast mund të parashikohet se mund të ketë një ndikim material negativ mbi vlefshmërinë ose detyrimin e Pengut të krijuar këtu ose mbi të drejtat ose zhdëmtimet e Kredidhënesit;
- d) në rast se ndryshon emrin, Kredimarrësi do t'i japë, para se ndryshimi i emrit të bëhet efektiv ligjërisht, një njoftim me shkrim Kredidhënesit me emrin e ri dhe datën se kur do hyjë në fuqi ndryshimi i emrit; dhe
- e) do të bëjë, ekzekutojë, pranojë, dhe dorëzojë këtë formular njoftimi të regjistrimit dhe caktime të tjera, transferime, dokumentacione, veprime, çështje dhe fakte të tjera sic mund të kërkohet nga Kredidhënesi për të bërë efektive këtë kontratë;
- f) angazhimi i Kontratës së ktedise do të aplikohet gjithashtu tek kjo Kontratë e Pengut.

### 5.2 Verifikimi i kolateralit

Kredidhënesi do të ketë të drejtën në cdo kohë dhe herë pas here të verifikojë ekzistencën dhe statusin e kolateralit në cdo mënyrë që Kredidhënesi mund të konsiderojë si të pershtateshme dhe Kredimarrësi bie dakord të ofrojë gjithë mbështetjen dhe informacionin dhe të performojë gjithë këto veprime ose këtë qëllim për ti dhënë akses Kredidhënesit ose përfaqësuesve të tij të autorizuar në gjithë dokumentacionin që i përket kolateralit të ofruar nga Kredimarrësi.

### 5.3 Shpenzime

Kredimarrësit do t'i paguajnë Kredidhënesit me kërkesë, gjithë kostot e arsyeshme të Kredidhënesit, tarifat, dhe shpenzimet e dëshmuara me prova duke përfshirë, pa asnjë kufizim tarifat ligjore në lidhje me krijimin, regjistrimin, përfundimin ose ruajtjen e Barres Siguruese, detyrimin me cdo mjet të cdo dispozite këtu ose ushtrimin e të drejtave, fuqive, ose zhdëmtimeve në këtë dokument ose në përputhje me ligjin për Barrat e Sigurimit.

## Neni 6

### MBLEDHJA E KOLATERALIT NGA KREDIDHËNESI

#### 6.1 Mbledhja e kolateralit

Gjate ose pas ndodhjes së një ngjarje mospërmbushjeje, Barra e Sigurimit do të bëhet, sipas dëshires se Kredidhënesit, menjëherë e zbatueshme dhe ai autorizohet në mënyrë të pakthyeshme pa njoftim paraprak të Kredimarrësit dhe pa kërkesë tjetër, në varësi të ligjit në fuqi, të zbatojë të gjitha të drejtat e Kredidhënesit dhe mund të aplikojë cdo formë marrje të pengut për përmbushjen e detyrimit të siguruar nga barra e sigurimit pas zbritjes së shpenzimeve të arsyeshme të mbledhjes.

## Neni 7 TË PËRGJITHSHME

### 7.1 Siguri e vazhdueshme





Kjo kontratë dhe tarifat e sigurimit të krijuara këtu janë shtesë dhe jo zëvendësim për ndonjë tarifë tjetër sigurimi deri sa të përfundojë në formë të shkruar dhe e nënshkruar nga palët. Tarifa e sigurimit do të hiqet nga **Kreditori** brenda 15 ditëve pas shlyerjes së gjithë borxheve të mbetura, përfshirë principalin, interesin, tarifat, shpenzimet, etj.

## 7.2 Komunikim


Kardherë që ndonjëherë palë këtu t'i kërkohet ose të ketë të drejtën të njoftojë ose adresojë palën tjetër ose të bëjë një kërkesë mbi palën tjetër, ky njoftim, adresim, kërkesë do të bëhet në formë të shkruar dhe do ti jepet, nëse dorëzohet fizikisht, vetëm palës të cilës i drejtohet ose mund të dërgohet me email i adresuar për palën të cilës i drejtohet në adresën e kësaj pale sic është përcaktuar më poshtë ose sic është ndryshuar, duke patur parasysh që ky ndryshim adrese ti dorëzohet palës tjetër në mënyrën e përcaktuar më sipër.

*Kjo kontratë, pasi iu lexua me ze të lartë e të qartë paleve të njohur prej meje Noterit dhe të pranuar prej tyre, dhe ato e gjeten përmbajtjen e saj në përputhje me vullnetin e tyre të plote e të lire, nënshkruhet rregullisht prej tyre para meje Noterit dhe une Noteri vertetoj sa me sipër sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë.*


### KREDIDHENES

ProCredit Bank sh.a,  
Perfaqesuar nga:

  
Emer Mbiemer Firme


  
Emer Mbiemer Firme

### NOTER




### KREDIMARRES

Smart Watt SHPK  
Perfaqesuar nga:

  
Emer Mbiemer Firme

PENG-LENESI  
E T S SHPK  
Perfaqesuar nga:

  
Emer Mbiemer Firme







REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCEVE DHE EKONOMISË  
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

**EKSTRAKT I REGJISTRIT TREGTAR PËR TË DHËNAT E  
SUBJEKTIT "SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR"**

**GJENDJA E REGJISTRIMIT**

1. Numri unik i identifikimit të subjektit (NUIS)	L72320013B	
2. Data e Regjistrimit	20/11/2017	
3. Emri i Subjektit	Smart Watt	
4. Forma ligjore	SHPK	
5. Data e themelimit	17/11/2017	
6. Kohëzgjatja	Nga: 17/11/2017	
7. Zyra qendrore e shoqërisë në Shqipëri	Tirane Kashar KASHAR Autostrada TR-DR, Rruga Egnatia, Tirana Industrial Park Kashar	
8. Kapitali	100,00	
8.1 Numri i përgjithshëm i kuotave	1,00	
9. Objekti i aktivitetit	Shoqëria ka për objekt të saj kryerjen dhe marrjen pjesë në të gjitha aktivitetet që një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar mund të ushtroje në baze të legjislacionit shqiptar, dhe në veçanti: Kryerje e aktivitetit të import, eksport, tregtim dhe furnizim me shumice dhe pakice të energjisë elektrike si brenda dhe jashtë Shqipërisë. Ndertimin e impianteve të energjisë së rinovueshme. Prodhim të energjisë. Studim dhe konsulence në aktivitetin e energjisë elektrike. Kryerja e çdo aktiviteti të lejuar nga legjislacioni për shoqëritë tregtare.	
10. Administratori/ët	Shefki Dema	
10.1 Afati i emërimit	Nga: 20/06/2019	Deri: 20/06/2024
11. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore		
11.1 Kufizimet e kompetencave (nëse ka)		
12. Ortakët	E T S SHPK	
12.1 Vlera e kapitalit	Para: 100,00	
12.2 Numri i pjesëve	Natyre:	
12.3 Pjesëmarrja në përqindje (%)	1,00	





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË  
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

	100,00
12.4 Komete (nëse ka)	
13. Vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit	Fier Topoje SHEQ MARINAS Njesia Administrative Topoje, Fshati Sheq Marinas Topoje, Pasuria me Nr. 556/2, ne zonen kadastrale 3358
14. Të dhëna që njoftohen vullnetarisht	Emri Tregtar: Smart Watt E-Mail: shefkidema@gmail.com Telefon: 0674043010
15. Statusi:	Aktiv

Datë: 26/11/2020

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi  
(i nëpunësit të sportelit)



Vulosur elektronikisht nga Qendra Kombëtare e Biznesit me anë të një procedure automatike nga Data: 2020/11/26 12:43:00 100,00  
L72320013B20201126124319832006





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCEVE DHE EKONOMISË  
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

## EKSTRAKT I REGJISTRIT TREGTAR PËR TË DHËNAT E SUBJEKTIT “SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR”

### GJENDJA E REGJISTRIMIT

1. Numri unik i identifikimit të subjektit (MUIS)	K21307003N
2. Data e Regjistrimit	04/01/2002
3. Emri i Subjektit	E T S SHPK
4. Forma ligjore	SHPK
5. Data e themelimit	21/07/2001
6. Kohëzgjatja	Nga: 21/07/2001
7. Zyra qendrore e shoqërisë në Shqipëri	Tirane Kashar KASHAR Autostrada TR-DR, Rruga Egnatia, Tirana Industrial Park, kashar
8. Kapitali	52.795.000,00
8.1 Numri i përgjithshëm i kuotave	1,00
9. Objekti i aktivitetit	Ndertimi dhe instalimi i impianteve elektrike të tensionit të ulët, të mesëm dhe të lartë. Prodhim, importim, tregtim, shitje, montim dhe çmontim të aparaturave dhënes-marrës GSM/UMTS, antenave, kullave dhe çdo lloj aparature tjetër të telefonisë celulare. Ndertim dhe instalim i impianteve telefonike, i impianteve termohidraulike, impianteve të kondicionimit. Punime mekanike të ndryshme. Automatizimi i proceseve të ndryshme të prodhimit. Import-eksport i të gjitha materialeve që kanë të bëjnë me objektin e veprimtarisë. Pjesëmarrje direkte ose indirekte në fushën e turizmit, transportit. Studim, projektim, konsulence dhe ekspertizë në fushën e energjisë elektrike; Nënstacione, Linja të Tensionit të Ulet, të Mesëm dhe të Lartë. Hidrocentrale, Sistemin e mbrojtjes, matjes dhe Monitorimit të energjisë, Parqe Fotovoltaike dhe Eloi. Prodhim dhe shitje të energjisë elektrike. Projektim dhe Implementim të Sistemit SCADA. Ndertime të Parqeve dhe impianteve të prodhimit të energjisë elektrike, ndertesave civile dhe industriale, kanalizime, bazamente betoni, montim konstruksione





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË  
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

	metalikeet. Impiante te sinjalistikes ndricuese dhe jo ndricuese.	
10. Administratori/ët	Shefki Dema	
10.1 Afati i emërimit	Nga: 15/12/2013	Deri: 15/12/2023
11. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore		
11.1 Kufizimet e kompetencave (nëse ka)		
12. Ortakët	FatosAliaj	
12.1 Vlera e kapitalit	Para: 52.795.000,00	Natyre:
12.2 Numri i pjesëve	1,00	
12.3 Pjesëmarrja në përqindje (%)	100,00	
<i>*Të përfaqësuarit, (Plotësohet vetëm nëse një kuotë zotërohet në bashkëpronësi)</i>		
12.4 Komente (nëse ka)		
13. Vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit		
14. Të dhëna që njoftohen vullnetarisht	Emri Tregtar: E T S SHPK E-Mail: shdema@ets-al.com Telefon: 2345122	
15. Statusi:	Aktiv	

Datë: 26/11/2020

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi  
(i nëpunësit të sportelit)



Vulosur elektronikisht nga Qendra Kombëtare e Biznesit me anë të një procedure automatike nga Data: 26/11/2020 10:59:10  
K21307003N20201126124419332006



SHOQERIA "SMART WATT" SH.P.K

Adrese : Tirane, Njesia Bashkiake Nr. 9, Blv Zogu I, Pallati Kirchberger, Kati 8, Ap.29.

Telefon: 0682034288

Nipt: L72320013B

**SHTESE VENDIM NR.1 E VENDIMIT TE ASAMBLESË SË ORTAKËVE DT  
06.05.2020 TË SHOQËRISË SMART WATT SH.P.K**

**ME NIPT: L72320013B**

Në TIRANË, sot më datë 17/10/2020 (DYMIJË E NJEZETE), Asambleja e Ortakëve të shoqërisë SMART WATT SHPK pasi mori në shqyrtim aktivitetin e shoqërisë duke patur parasysh ecurinë e saj aktuale dhe në të ardhmen dhe në përputhje me statutin dhe ligjin:

VENDOSI

Të miratojë lëvizjen si garanci në favor të **PROCREDIT BANK** :

- (i) të aseteve të luajtshme që janë në pronësi të shoqërisë.
- (ii) të çdo pasurie tjetër të luajtshme e të paluajtshme në pronësi të shoqërisë SMART WATT SHPK .
- (iii) të aseteve e pasurive që do të sigurohen nga financimi që do të merret pranë **PROCREDIT BANK**.
- (iv) të blloqeve aksionet e shoqërisë në masën 100% në QKB.

Të autorizojë përfaqësuesin ligjor të shoqërisë z. **Shefki Dema** për kryerjen e të gjitha veprimeve dhe firmosjen e të gjitha akteve të nevojshme për realizimin e qëllimit të këtij vendimi.

Ky vendim është i vlefshëm për gjithë jetegjatesinë e marrëdhënies kontraktuale me PROCREDIT BANK dhe çdo ndryshim i këtij vendim do të realizohet nëpërmjet shtesave përkatëse.

ORTAKËT

Ky vendim u firmos në prani të :

Fotos Aliq  
Emer mbiemer firme

Në prani të : Ivo Kocaj l.





SHOQERIA "E T S" SH.P.K

Adrese : Tirane Kashar Autostrada TR-DR, Rruga Egnatia, Tirana Industrial Park

Telefon: 0682034288

Nipt: K21307003N

**SHTESE VENDIM NR. I VENDIMIT TE ASAMBLESË SË ORTAKËVE  
DT 06.05.2020 TË SHOQËRISË "E T S" SH.P.K**

**ME NIPT: K21307003N**

Në TIRANE, sot më datë 03/11/2020 (**DYMIJË E NJEZETE**), Asambleja e Ortakëve të shoqërisë "E T S" SHPK pasi mori në shqyrtim aktivitetin e shoqërisë duke patur parasysh ecurinë e saj aktuale dhe në të ardhmen dhe në përputhje me statutin dhe ligjin:

**VENDOSI**


Te miratoje lenien peng dhe bllokimin e kuotave te shoqerise **SMART WATT** shpk me NIPT L72320013B (100% e kuotave zoterohen nga ETS shpk) per financimet qe shoqeria aktualisht ka dhe do te marre prane **PROCREDIT BANK** sha, deri ne shumen maksimale **1.500.000 Euro (Nje Milion e Peseqind Mije Euro)**, ne perputhje me kushtet e specifikuara ne kontratat qe do nenshkruhen midis paleve per kete qellim.

Të autorizojë perfaqesuesin ligjor te shoqerise z. **Shefki Dema** për kryerjen e te gjitha veprimeve dhe firmosjen e të gjitha akteve të nevojshme për realizimin e qellimit te ketij vendimi.

Ky vendim eshte I vlefshem per gjithe jetegjatesine e marredhenies kontraktuale me PROCREDIT BANK dhe cdo ndryshim I ketij vendim do te realizohet nepermjet shtesave perkatese.

**ORTAKËT**

Ky vendim u firmos ne prani te :

Fatos Aliu  


Në prani të Dorian Porroj  
